REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
Adresa: Bulevardi "Rinia" Maliq
Tel. & Fax. 0861 2 2026,

BUXHETI 2025



Dhjetor 2024

BASHKIA MALIQ

RELACION

MBI BUXHETIN E BASHKISË MALIQ PËR VITIN 2025

Dhjetor 2024

Përmbajtja e Buxhetit Vjetor 2025

Buxheti i Bashkisë Maliq për vitin 2025 paraqitet si një buxhet i balancuar (pa difiçit) ku të ardhurat e institucionit mbulojnë shpenzimet. Për çdo institucion buxheti është dokumenti më i rëndësishëm për të cilën ne përfshijmë një tërësi aktorësh jo vetëm si detyrim ligjor por edhe për të qenë sa më afër realitetit të qytetarëve por edhe grupeve të interesit . Në këtë kuadër janë realizuar dëgjesa publike në të gjithë territorin e bashkisë me drejtues institucionesh, kryetarë fshatrash, biznese, organizata joqeveritare e përfaqësues të këshillit të bashkisë.

Hartimi i buxhetit vjetor është një sfidë edhe për organet e vetëqeversisjes vendore të cilat me buxhetin e tyre duhet të jenë sa më afër qytetarëve për efekt të zgjidhjes së problematikave dhe realizimit të shërbimeve ndaj tyre.

Në planifikimin buxhetor kemi patur parasysh prioritetin e shërbimeve pa lënë mënjanë përmirësimin e infrastrukturës në të gjithë territorin e bashkisë, shërbimet sociale, arsim, bujqësi, rrugë rurale, emergjencat civile, mbrojtjen nga zjarri etj.

1. **Kuadri Ligjor**

Buxheti i vitit 2025 që po ju paraqesim për diskutim dhe miratim bazohet në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma dh), ligjin nr.9936,datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 "Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore", ligjin nr 9920,dt.19.05.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit Nr.68,datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ,VKM nr.503, datë 01.8.2024 për disa ndryshime në VKM nr.328, dt.31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page , dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" , Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 7/1,datë 28.02.2014 "Për përgatitjen e buxhetit vendor" , Shkresës së Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë me nr. 14488 prot.datë 29.10.2024 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2025" si dhe Ligjin "Për Buxhetin e Vitit 2025"

2. **Programet Buxhetore për Bashkinë Qendër do të jenë :**
   a) Planifikim,Menaxhim dhe Administrim 01110
   b) Shërbimet e Policisë Vendore 03140
   c) Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile 03280
   d) Fondi Rezervë 04910
   e) Arsimi bazë dhe parashkollor 09120
   f) Arsimi i mesëm i përgjithshëm 09230
   g) Kujdesi social PAK 10140

Në Programin Buxhetor të Planifikim,Menaxhim dhe Administrimit me organizimin e ri përfshihen edhe Shërbimet Bujqësore, Administrimi i Pyjeve në nivel planifikimi dhe kontrolli .

3. Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

a) Politikat kombëtare financiare bazohen në parimin e shumëllojshmërisë të të ardhurave, realizimin dhe menaxhimin në mënyrën më të plotë dhe saktë të mundshme të tyre bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
b) Funksionet dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen gjithmonë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre;
c) Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat e veta(taksa dhe tarifa vendore), fonde të transferuara nga qeverisja qëndrore, fondet që vijnë drejtpërdrejtë nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, donacione si dhe burime të tjera të parashikuara me ligj.
d) Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur;
e) Në rastet e ndryshimeve të politikave fiskale Ministria e Financave dhe Ekonomisë është e detyruar të marrë masa për kompesimin e efekteve financiare nëpërmjet rritjes së transfertave sipas zërave;
f) Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa difiçit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore;

4. Objektivat e buxhetit vendor

a. Një sistem të financave të Bashkisë Maliq sa më transparent, me përgjegjshmëri maksimale e në efiçencë të plotë të menaxhimit dhe përdorimin e burimeve publike nga të gjithë aktorët ;
b. Qëndrueshmëri të financave duke mos krijuar borxhe në të ardhurat vendore;
c. Shlyerje të detyrimeve nga një vit më parë duke ruajtur qëndrueshmërinë buxhetore;
d. Forcim të disiplinës financiare nëpërmjet zbatimit dhe kontrollit të të gjitha akteve ligjore në fuqi;
e. Përmirësim në raportim dhe monitorim të performancës financiare ;
f. Rritja e transparencës në mbledhjen dhe përdorimin e fondeve publike ;
g. Evidentim të riskut dhe marrje masash në minimizimin e rasteve që e shkatojnë atë;
h. Realizimin e një qeverisje efikase me nivel dhe sa më afër qytetarëve nëpërmjet :
    - Respektimit të të drejtave të komunitetit;

- Ushtrimit të funksioneve në mënyrë sa më efektive;
- Realizimi i shpenzimeve të domosdoshme dhe me standartet e kërkuara;
- Nxitja e komunitetit për pjesëmarrje në vetëqeverisje me takime direkte, konsulta, informime e pjesëmarrje në vendimmarrjet e Këshillit të Bashkisë për këtë qëllim ;
- Kontroll në vazhdimësi të të gjithë veprimtarisë ekonomiko financiare të strukturave të bashkisë me qëllim përmirësimin e punës;

Objektivat strategjike të buxhetit përfshijnë:

Objektivi strategjik 1: Zhvillim ekonomiko-social i qëndrueshëm i bashkisë duke synuar realizimin e sa më shumë shërbimeve ndaj komunitetit sipas problematikave të dala në dëgjesat me komunitetet respektive;

Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës vendor bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe prioriteteve të dala nga komunitetet;

Objektivi strategjik 3: Rritja e kapaciteteve prodhuese të tokës bujqësore, duke marrë në konsidertë shqetësimin e fermerëvë me ide kreative të specialistëve tanë nga planifikimi, menaxhimi, standartizimi e deri në shitjen e produktit në pikën fundore;

Objetivi strategjik 4: Mbështetja maksimale në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre fushave prioritare;

Objektiv strategjik 5. Mbështetje për zonën rurale veçanërisht në fushën e blegtorisë e turizimit nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve dhe rritjes së turizmit malor në zonën e Gorës dhe Moglicës;

Objektiva të tjera për buxhetin e vitit 2025 do të jenë:

a) Rritje të burimeve financiare në dispozicion të bashkisë nga buxheti i shtetit, të ardhurat e veta apo donacionet e ndryshme duke minimizuar informalitetin;
b) Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial nëpërmjet shpërndarjes sa më të drejtë të transfertave buxhetore apo të ardhurave të veta;
c) Ofrimin e sa më shumë shërbimeve për qytetarët me cilësi dhe në kohë;
d) Përmirësim të mëtejshëm të infrastrukturës vendore nëpërmjet financimit nga buxheti i shtetit, donatorët dhe të ardhurat e vetë institucionit;
e) Përmirësi i kushteve dhe standarteve në institucionet arsimore;
f) Minimizimin e informalitetit ;
g) Zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor ;
h) Promovim i vlerave arkeologjike e turistike të zonës sonë me projekte konkrete;

i) Zhvillimi i agroturizmit;
j) Përmirësim të klimës së biznesit;
k) Krijimi i partneriteteve kombëtare e ndërkombëtare;
l) Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave të urbanizuara ;
m) Sigurimi i kohezionit social nëpërmjet rritjes së performancës së institucioneve shëndetësore, arsimore e qendrave të zhvillimit të vazhdueshëm profesional;
n) Dhënie mundësie dhe mbështetje e biznesit për të siguruar akses punësimi për njerëzit e prekur nga varfëria dhe përjashtimi social;
o) Mbrojtja dhe promovimi i burimeve natyrore e kulturore;
p) Promovimi dhe përmirësimi i monumenteve dhe vendeve arkeologjike;
q) Rrjetëzimi i kulinarisë, eventeve, aktiviteteve kulturore deri në krijimin e destinacioneve me interes turistik;

Hapat e ndjekur :

- Buxheti i vitit 2025 ndoqi të gjitha hapat e përcaktuara në ligj apo akte të tjera nënligjorë . Nga ana jonë u realizuan takime, dëgjesa publike me banorë , grupe interesash , drejtues institucionesh , organizata joqeveritare, anëtarë të Këshillit të Bashkisë ,Kryetarë të Fshatrave, etj .
- Nga ana tjetër nëpërmjet strukturave të bashkisë u analizuan kostot e shërbimeve dhe investimeve sipas objektivave dhe programeve duke përcaktuar prioritetet për çdo program apo strukturë buxhetore me çmimet reale të tregut ;
- Takime me drejtues të institucioneve arsimore, përfaqësues të organizatave jo fitimprurëse (OJF), grupe të interesit duke evidentuar të gjitha problematikat, sugjerimet e prioritetet.
- Në bashki qendër u realizua edhe një takim me banorë, biznese, këshilltarë duke dhënë një pasqyrë të shkurtër për performancën e bashkisë për vitin 2024 dhe problematikat që duhet të kemi parasysh gjatë vitit 2025, ku u morrën mendime me qëllim përmirësimin e punës në vazhdimësi.

Synimi në vazhdimësi :

- Përdorimi me sa më shumë efektivitet i transfertës së pakushtëzuar e specifike ;
- Përmirësim i paketës fiskale, eleminim në maksimum të informalitetit në territor dhe mbledhja e debitorëve nga vitet e kaluara ;
- Rritje e efiçencës dhe cilesisë të shërbimeve publike, me administrim dhe qeverisje më të mirë ;
- Nxitje dhe zhvillim ekonomik vendor e mbështetje për bizneset ;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në raport me komunitetet dhe Këshillin e Bashkisë;

- Rritje e disiplinës financiare e menaxhim sa më të mirë i shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e sa më shumë shërbimeve dhe investimeve për komunitetin;
- Përtej qëllimit ekonomik, synojmë të krijojmë edhe një mjedis shoqëror sa më të shëndetshëm nga i cili të përfitojë i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët të mbizotërojë;.

I-Planifikimi i të Ardhurave

Buxheti që po ju paraqesim për vitin 2025 përfshin:

1. Transferta e Pakushtëzuar është çelur **480,801 mijë lekë** ose **13.54 %** më shumë se viti 2024. Në vitin 2024 kjo transfertë ka qenë 423,481 mijë lekë me një shtesë prej 57,320 mijë lekë.
2. Në buxhetin e vitit 2025 si pjesë e transfertës së pakushtëzuar është parashikuar edhe një fond për efekt të Rritjes së Pagavë në shumën **52,099 mijë lekë** dhe Menaxhimit të Mbetjeve në shumën **8,000 lekë**
3. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale për funksionet shtesë kap shumën **223,821 mijë lekë** me një shtesë 37,729 mijë lekë.
4. Transferta e Përgjithshme e Buxhetit 2025 kap shumën **704,622 lekë** ose 95,049 lekë më shumë
5. Të ardhurat nga buxheti i pavarur për vitin 2025 janë planifikuar në shumën **300.050 mijë lekë,** ;
6. Në total buxheti i vitit 2025 kap shumën **1,004,672 mijë lekë** , me një rritje në shumën 94,575 mijë lekë ose **10.4 %** më shumë.

   Të ardhura të mbartura nga viti 2024 prej transfertës apo nga të ardhurat e veta nuk do të jenë pjesë e këtij buxheti, pasi buxheti i vitit 2024 mbyllet më 31 Dhjetor dhe shuma që do të rezultojë e pa përdorur mbas rakordimit në fund të vitit me Degën e Thesarit Korçë do të miratohet me buxhetin shtesë në fillim të vitit 2025;

Në Paketën Fiskale 2025 ju kemi propozuar edhe disa përjashtime :

1. Për bizneset e reja, të cilat administrohen nga gratë kryefamiljare, tarifat vendore reduktohen në masën 30% për vitin e pare të ushtrimit të aktivitetit.
2. Për bizneset e reja, të hapur rishtazi, të cilat admnistrohen nga të rrinj të moshës 18-25 vjeç, përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore për vitin 2025. (*Për subjekte të reja , me objekt të ndryshëm nga aktiviteti familjar primar.*)
3. Familjet që trajtohen në ndihmë ekonomike apo që përbëhen vetëm nga "*pensionistë të vetmuar*" të paguajnë vetëm 70 % të tarifave vendore.- Në kategorinë "*pensionistë të vetmuar*" përfshihen të gjithë pensionistët e vetëm, pa përkrahje, që jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Lista me të dhënat për këta persona do të përcaktohet nga Sektori i Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Maliq.

4. Gratë kryefamiljare që nuk janë në marrëdhënie pune përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore.
5. Përjashtime në tarifën e Gjelbërimit, Pastrimit, Ndriçimit dhe Mirëmbajtjes së kanaleve Kullues për zona malore ku efektivisht nuk kryhen këto shërbime sipas përcaktimit në Paketën Fiskale.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
e) pasuritë e paluajtshme - ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
g) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/ pension social/ kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
h) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
i) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Të tjera

- Përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore, tokat bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për **5 vitet** e para nga çasti i mbjelljes.

Të ardhurat sipas burimeve të financimit për vitin 2025

Nr.	BURIMET E FINANCIMIT	Shuma *lekë 2024*	Shuma **lekë 2025**	**Shtesa** *në lekë*
I	**Të ardhurat Grande + Të Ardhurat e veta**	**724,005,301**	**780,851,000**	**56,845699**
1	Transferta e Pakushtëzuar	423,481,000	480,801,000	**57,320,000**

2	Buxheti Pavarur	300,524,301	300,050,000	-474,301
II	**Transferta Sektoriale**	**186,092,000**	**223,821,000**	**37,729,000**
1	Arsimin parashkollor-Personel mësimor	90,212,000	119,221,000	29,009,000
2	Arsim parashkollor-Staf mbështetës	4,744,000	4,934,000	190,000
3	Arsimin parauniversitar	12,521,000	13,021,000	500,000
4	Administrimi i pyjeve	6,879,000	7,154,000	275,000
5	Rrugët	10,729,000	11,066,000	337,000
6	Ujitja dhe kullimi	45,360,000	47,172,000	1,812,000
7	Mbrojtja nga Zjarri	15,647,000	21,254,000	5,607,000
	TOTALI	**910,097,301**	**1,004,672, 000**	**94,575,000**

Të ardhurat e buxhetit të pavarur janë përllogaritur bazuar në Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me taksat apo tarifat vendore.

Buxheti për vitin 2025 përbëhet nga këta komponentë :

I-BASHKIA QENDËR

A-PAGA + SIGURIME SHOQËRORE

Fondi i pagave për Administratën e Bashkisë, Strukturave Sektoriale (Arsim , MZSH) është përllogaritur bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.503, datë 1.8.2024 për disa ndryshime në VKM nr. 328, dt.31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page , dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", si dhe vendimmarrjeve të Këshillit të Bashkisë apo Kryetarit të Bashkisë bazuar në kompetencat që ju jep Ligji nr.139/201 ''Për vetëqeverisjen vendore'' neni 54/ç e 64/j.

Programet buxhetore që po ju paraqesim kanë për qëllim :

- Menaxhimin sa më efektiv të burimeve njerëzore , rritja e aftësive funksionale dhe performancës të çdo punonjësi ;

- Trajnim të punonjësve duke synuar objektivat që kërkon koha dhe institucioni ;
- Ofrim të shërbimeve të plota, cilësore dhe në një kohë të shkurtër për biznesin dhe për qytetarët ;
- Krijimi i një administrate sa më profesionale,të aftë për të përballuar sfidat e përditshme ;
- Menaxhim me efiçencë të fondeve të vëna në dispozicion ;
- Administrim të sistemit tatimor në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi ;
- Transparencë, informim dhe asistencë ligjore për të gjithë tatimpaguesit ;
- Nxitje të qytetarëve, biznesit dhe palëvë të interesuara për t'u bërë pjesë e planifikimit të buxhetit ;
- Evidentim dhe përkrahje të familjeve realisht të varfëra ;
- Gjetjen e burimeve alternative për financimin e buxhetit dhe arritjen e objektivave ;
- Mbështetje për rininë, sportin, artin dhe kulturën ;

Produktet që duam të ofrojmë :

- Ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në kohën më të shpejtë të mundshme me cilësi e transparencë ;
- Staf i trajnuar në vazhdimësi me institucione publike apo donatorë të specializuar ;
- Programe buxhetore afatmesëm dhe vjetorë për një administrim sa më të mirë ekonomiko-financiar të bashkisë ;
- Ulje e informalitetit në fushën e biznesit ;
- Mbështetje me ndihmë sociale për gratë e fëmijëve në risk dhe zbutje të varfërisë për familjet në nevojë ;
- Lehtësi fiskale për shtresat në nevojë ;
- Ndjekje në vazhdimësi të emergjencave civile duke mbuluar detyrimet ligjore për të dëmtuarit ;
- Shpejtësi në veprim të shërbimit të mbrojtjes kundra zjarrit dhe shpëtimit
- Mjedise arsimore me standarte bashkëkohore e sa më funksionale ;

Tabela përmbledhëse Paga + Sigurime Shoqërore për Bashkinë Qendër :

000//lekë

Nr.	Programi	Kodi	Nr.Punonj.		Paga	Sigurime Shoq.+ Shënd.	Paga+ Sigurime
			E veta	Sekt.			
1	Aparati Administrativ	0 1110	165	-	162,206	27,117	189,323
2	Policia	0 3140	12	-	10,356	1,730	12,086
3	MZSH	0 3280	2	14	15,670	2,617	18,287
4	Sektori Mbështetës	0 6260	9	-	5,838	975	6,813
5	Arsimi 9-vjeçar	0 9120	-	94	103,421	20,734	124,155
6	Arsimi i mesëm	0 9230	-	16	10,846	2,175	13,021
	Shuma		**188**	**124**	**308,337**	**55,348**	**363,685**

B-SHPENZIME OPERATIVE

Shpenzimet operative përdoren për mbulimin e funksioneve të përcaktuara me ligj apo akte nënligjore. Peshën me të madhe të shpenzimeve e mbulojnë mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe institucioneve të tjera si dhe ato në fushën e kullimit, rrugëve, ngrohjes, ndriçimit publik etj. Ato do të mbulohen nga të ardhurat e bashkisë . (Transfertë +BP) si më poshtë vijon:

Nr.	Programi	Kodi	*000/lekë*
1	Aparati Administrativ	01110	53,981
2	Policia	03140	1,266
3	MZSH	03280	3,127
4	Sektori Mbështetës	06260	65,045
5	Arsimi 9-vjeçar	09120	370
6	Arsimi i mesëm	09230	290
	Shuma 602		**124,079**

C- TRANSFERTA, FOND SOCIAL, FOND REZERVË, EMERGJENT

000/lekë

Nr.	Art.	Emërtimi	
1	604	Transfertë Drej.Tatimeve	50
2	''	Transfertë Klubi Futbollit Maliq sha	10,804
3	''	Trasfertë Kombinati Sheqerit	5,200
4	''	Fond Këshilli Qarkut	300
5	606	Fond Social	1,000
6	''	Fond Emergjenca Civile	4,000
7	''	Transfertë tek individët	120
8	''	Bursa nxënësit ekselentë	500
9	609	Fond Rezervë	2,000
		Shuma	**23,974**

D-INVESTIME

Nr.	Art.	Emërtimi	*000/lekë*
1	230	Projekte	1,100
2	231	Ndërtime konstruksione	27,765
3	''	Rrugë	67,118
4	''	Ujësjellsa,KUZ	7,700
5	''	Pajisje, Instalime teknike	1,890
7	''	Inventar ekonomik	9,516

8	''	Mbikqyrje-Kolaudim	2,000
		Investime të reja Viti 2025	**117,089**
		Investime në proces	**109,704**
		Totali 2025	**226,793**

E-INVESTIME 3-VJEÇARE **95,000 lekë**

Gjatë vitit 2025 të realizohen dy investime të shtrira në kohë për periudhën 2025-2027 si më poshtë:

a) **Sistemim – Asfaltim rrugë viti 2025"** në shumën 100,000 mijë lekë të ndara në financim:
Viti 2025 30,000 mijë lekë
Viti 2026 35,000 mijë lekë
Viti 2027 35,000 mijë lekë

b) **"Ndërtim korsi biçikletash dhe trotuare Kryqëzimi Libonik, Pylli Fazanëve"** në shumën 30,000 mijë lekë të ndara në financim
Viti 2025 5,000 mijë lekë
Viti 2026 25,000 mijë lekë

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E SHPENZIMEVE TË BASHKISË QENDËR

Nr.	Emërtimi i Shpenzimit	Plani 2025 *000/lekë*	
I	**Shpenzime për paga**	**308,337**	
II	**Sigurime Shoqërore & Shëndetësore**	**55,348**	
III	**Shpenzime Operative**	**124,079**	
	-Mallra dhe Shërbime	106,307	
	-Këshilltarë, K. Fshati	17,772	
IV	**Investime**	**226,793**	
	-Investime viti 2025 -Investime në proces nga viti 2024	117,089 109,704	
V	**Transferta të Tjera**	**23,974**	
	-Transferta tek institucione	16,354	
	-Transf. tek individë- Fond Social.Mb.Civile,Bursa	5,620	
	-Fond Rezervë,Kontigjencë	2000	
	TOTALI I-V	**738,531**	

-Paga + Sigurime Shoqërore 49 %
-Shpenzime Operative 17 %
-Transferta, Fond Social, Emergjenca, Fond Rezervë, Kontigjencë,Bursa 3 %
-Investime 31 %

E-TË TJERA

1. Të tjera transferta 0.1 % + DRT (50) **50,000** lekë
2. Transfertë Keshilli i Qarkut **300,000** „

3. Fond Rezervë **2,000,000** „
4. Fond për Mbrojtjen Civile **4,000,000** „
5. Fond Social **1.000.000** „
6. Transferta për Klubin e Futbollit Maliq sha **10,804,000** „
7. Transferta për Komnbinatin e Sheqerit **5,200,000** „
8. Investime në proces 2024 **109,704,000** „
9. Investime viti 2025 **117,089,000** „
10. Investime 2026-2027 **95,000,000** „

11. Limiti i shpenzimeve operative për karburant të mjeteve:
    a. Benc AB 797 ML 450 litra gazoil/muaj
    b. Benc AA 797 IR 150 litra gazoil/muaj
    c. Benc AA 424 EA 70 litra gazoil/muaj
    d. Toyota AA 076 TU 200 litra gazoil/muaj +300 litra/vit për Këshillin e Bashkisë
    e. BMW AB 363 HE 200 litra gazoil/muaj
    f. Peugeot AB 833 GU 100 litra gazoil/muaj
    g. Mini Buz AA488JO 200 litra gazoil/muaj
    h. Gjenerator 200 litra gazoil/vit
    i. Mjetet Zjarrfikës (3 copë) 4,500 litra për të gjithë vitin kalendarik
        - AA 762 VU 1,700 litra/vit
        - AA 071 UO 2,100 litra/vit
        - AB 096 GB 700 litra në vit
    j. Kaldaja e Shk. 9-vj. Maliq 7,000 litra / vit
    k. Kaldaja e Shk. 9-vj.Shqitas 4,000 litra / vit

12. Shpenzime telefonike për titullarin deri 10.000 lekë/muaj por pa kaluar 2% të shpenzimeve operative të aparatit administrativ sipas Vendimit Nr.673 datë 02.09.2020 pika 10 i ndryshuar;
13. Detyrim për shoqërinë e mbetjeve urbane KRWM 14,000 mijë lekë
14. Kontribut për Shoqatën për Autonominë Vendore 640 mijë lekë
15. Shpenzime për sipërmarrjen e pastrimit 46,320 mijë lekë
16. Shpenzime për Akademinë e Pushtetit Vendor (trajnime) 477 mijë lekë
17. Mirëmb. Programi i tatimeve, financës,faqe bashkisë 2,000 mijë lekë
18. Shpenzime për Këshillin e Bashkisë dhe kryetarëve të fshatrave Viti 2025

➢ Anëtarët e Këshillit të Bashkisë

Në buxhetin e vitit 2025 ju kemi propozuar shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Bashkisë në masën 10 % të pagës së Kryetarit të Bashkisë . Propozimi vjen bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" datë 17.12.2015 neni 51 "Të drejtat e këshilltarëve" pika 1 ku përcaktohet : Këshilltari kryen funksionin me shpërblim mujor të barabartë me 10 % të pagës mujore të kryetarit të bashkisë. Efekti financiar për këtë zë kap shumën :

31 këshilltarë X 26,000 x 12 muaj = **9,672,000 lekë**

- Sekretari i Këshillit të Bashkisë

-Paga e Sekretarit të Këshillit të Bashkisë kap një efekt financiar: 1,347,000 lekë

- Shpenzime operative 28,000 lekë
  - Bojë printer 18,000 lekë
  - -Kancelari 20,000 lekë
- Trajnim këshilltarët 200,000 lekë
- Dieta 50.000 lekë
- Shpërblim kryetarë fshatrash

  -Në buxhetin e vitit 2025 ju kemi propozuar një shpërblim në masën 10 % të pagës së Administratorëve të Njësive Administrative sipas fshatrave që mbulojnë. Ndërsa Kryetarët e Fshatrave në Bashkinë Qendër do të puguhen në masën 6 % të pagës së Kryetarit të Bashkisë Efekti financiar për kryetarët e fshatrave që janë zgjedhur sipas vendimit të marrë nga Këshilli i Bashkisë shkon **8,100,000 lekë**

Totali i Shpenzimit Këshilltarë + Kryetarë Fshati

Nr.	Emërtimi	*në/lekë*
1	Shpërblim këshilltari	9,672,000
2	Sekretari i këshillit	1,347,000
3	Kancelari	20,000
4	Shpërblim kryetar fshati	8,100,000
5	Trajnim	200,000
6	Dieta	50,000
8	Boje printeri	18,000
9	Gazoil	51,000
	Totali	**19,458,000**

19. **Shpenzime për Mbrojtjen Civile**

Në lidhje me shpenzimet për Mbrojtjen Civile sqarojmë :

Në buxhetin e Bashkisë Maliq për vitin 2025 Emergjencave Civile janë në nivel sektori sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në buxhetn e vitit 2025 janë parashikuar :

a) Fond "Për Mbrojtjen Civile" 4,000,000 lekë (nga fondet e veta)
b) Në fillim të vitit buxhetor Ministria e Mbrojtjes – Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile akordon edhe fondin specifik për Emergjencat Civile të cilën do ja sjellim Këshillit të Bashkisë për miratim.

Sqarim: Me ndarjen që kanë pësuar strukturat këtë vit për efekt të mbulimit të emergjencave civile në Agjencinë e Shërbimeve Mbështetëse kemi parashikuar edhe 15,756 mijë lekë për struktura e mëposhtëme. :

-Fond për karburant për pastrim kanalesh kullues,vaditës, prita,rez etj 10,756 mijë lekë ;

-Fond për mirëmbajtje rrugë rurale 5,000 mijë lekë

- ***Në buxhet kemi përfshirë për efekt të buxhetimit me pjesëmarrje edhe pjesën e barazisë gjinore , gratë dhe të rinjtë .*** Bazuar në ligjin 9970 datë 24.07.2008 " Për barazinë gjinore në shoqëri " neni 7, neni 15, Ligji 68/2017 " Për finacat e vetëqeverisjes vendore " neni 2,neni 36,neni 54, Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 64, kemi marrë masa për hartimin e zërave buxhetore duke i shoqëruar dhe me shpenzimet përkatëse , në bazë të dëgjesave publike për buxhetimin me pjesëmarrje dhe kërkesave të paraqitura në këto dëgjesa si më poshtë vijon :
  - Në strukturën administrative kemi përqindje të lartë të grave pjesëmarrëse në administratë si në nivele të larta drejtuese , nivel drejtori dhe nivel pergjegjësi .
  - Përsa i përket zërave të buxhetit kemi parashikuar fond social (Për dhunen ne familje , për strehimin ,për gratë e veja)
  - Kemi parashikuar rehabilitim objekte shkollore kryesisht kopshte ,hartim projektesh për kënd lojërash për fëmijë ,terren sportiv në fshatin Bregas për të rinjtë ,përfundimi i Qëndrës Komunitare Maliq e cila do të jetë një qendër aktivitetesh për të gjitha moshat e gjinitë,ndërtim korsi bicikletash e trotuaresh nga rrethrrotullimi Libonik deri në Pylli i Fazanëve .
  - Gjithashtu është ndërmarrë dhe një nismë për lehtësimin e barrës fiskale për taksat dhe tarifat vendore për gratë kryefamiljare që nuk janë në marëdhënie pune .Gratë e vajzat që hapin aktivitet të ri ju falen për 1 vit tarifat vendore .

Këto janë nismat e para që ne si institucion ndërrmarim për vitin buxhetor 2025 dhe shpresojmë të kemi mbështetje e nga donator të ndryshëm për këtë kategori.

II-AGJENCIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Organizimi i Agjencisë të Shërbimeve mbështetëse është bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.98,datë 30.9.2024 ''Miratimin e numurit të punonjësve dhe nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera të varësisë'' pika III. Bazuar në këtë organizim të ri strukturat buxhetore në nivel programi do të jenë si më poshtë :

a) Shërbimi Publik 06260
b) Mekanika 06260
c) Ujitje Kullimi 04240
d) Pyje-Kullota 04260
e) Rrjeti Rrugor Rural 04520
f) Kultura 08220

Bazuar në këtë vendimmarrje kemi hartuar nivelin e shpenzimeve dhe strukturave të tjera buxhetore sipas Projekt-Vendimit bashkëlidhur. Shpenzimet buxhetore sipas strukturave do të jenë si më posht vijon :

Tabela përmbledhëse Paga + Sigurime Shoqërore për Agjencinë e Shërbimeve Mbështetëse :

Nr.	Programi	Kodi	Nr.Punonj.		Paga	Sigurime Shoq.+ Shënd.	Paga + Sigurime
			E veta	Sekt.			
1	Shërbimi Publik	0 6260	177		99,606	17,136	116,742
2	Mekanika	0 6260	22		14,070	2,350	16,420
3	Ujitje -Kullim	0 4240		40	26,674	4,455	31,129
4	Pyjet	0 4260	23	6	18,742	3,130	21,872
5	Rrugët	0 4520	4	20	12,814	2,178	14,992
6	Kultura	0 8220	19		13,453	2,247	15,700
	Shuma		**245**	**66**	**185,359**	**31,496**	**216,855**

Pra rezultojnë 245 punonjës që mbulohen nga fondet tona dhe 66 punonjës nga fondet sektoriale.

Shpenzimet operative

Nr.	**Programi**	**Kodi**	***000/lekë***
1	Shërbimi Publik	0 6260	6,972
2	Mekanika	0 6260	11,806
3	Ujitje -Kullim	0 4240	16,043
4	Pyjet	0 4260	245
5	Rrugët	0 4520	5,200
6	Kultura	0 8220	4,050
	Shuma 602		**44,316**

Investime

Nr.	**Art.**	**Emërtimi**	*000/lekë*
1	231	Pajisje, Instalime teknike	4,370
2	''	Inventar ekonomik	600
		Totali 2025	**4,970**

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E SHPENZIMEVE TË AGJENCISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr.	**Emërtimi i Shpenzimit**	**Plani 2025** *000/lekë*
I	**Shpenzime për paga**	185,359
II	**Sigurime Shoqërore & Shëndetësore**	31,496
III	**Shpenzime Operative**	44,316
IV	**Investime**	4,970
	TOTALI I-IV	**266,141**

Limiti i shpenzimeve operative për karburant të mjeteve:

a.	Furgon AA 861 RI	150 litra gazoil/muaj
b.	Xhip AA 399 NL	250 litra gazoil/muaj
c.	AB132MJ	100 litra gazoil/muaj
d.	Mjeti Benc KO 4648 O	150 litra gazoil/muaj
e.	Ford AA 221 GR	250 litra gazoil/muaj
f.	Ford AA 213 GR	200 litra gazoil/muaj
g.	Ford AA 214 GR	200 litra gazoil/muaj
h.	Ford AA 224 Gr	200 litra gazoil/muaj
i.	Sprint AB522 HB	200 litra gazoil/muaj
j.	Kamioni AA 371 PG	600 litra gazoil/muaj
k.	Bobkat	200 litra gazoil/muaj
l.	Traktor me zinxhira	500 litra gazoil/muaj
m.	Borëpastruese	1,000 litra gazoil/vit;
n.	Bobkat UNV	300 litra gazoil/muaj
o.	Xhip AA 430 PG	150 litra gazoil/muaj
p.	Fadroma	300 litra gazoil/muaj
q.	Kamioni AB155 OJ	1000 litra gazoil/muaj
r.	Eskavatorët	45.000 litra gazoil për gjithë vitin kalendarik;
s.	Benzinë për motoçikleta	500 litra / vit
t.	Benzinë për korrëse bari	800 litra / vit

Shpenzimet e mësipërme janë detajuar në tabela të ndara për efekt planifikimi, menaxhimi dhe shpenzimi.

Ky organizim mendojmë do të jetë më efektiv dhe më i shpejtë në realizimin e punëve dhe shërbimeve në komunitet .

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.6280 Prot . Maliq, më 26.12.2024

VENDIM
Nr. 130 **datë** 26.12.2024

Për

"Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjes vendore*" neni 54 "Detyrat *dhe kompetencat e këshillit bashkiak*" germa (dh), Ligjit nr.9936, date 26.6.2008 "Për *menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" neni 32 "*Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore*", Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "*Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 41, VKM nr.503, datë 1.8.2024 per sipas ndryshime në VKM nr.328,datë 31.5.2023 për "*Klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*", Udhëzimit 7/1, datë 28.02.2014 "*Për përgatitjen e buxhetit vendor*", Shkresës së Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë me nr.14488 prot.datë 29.10.2024 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2025" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

VENDOSI :

A-Të miratojë buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Maliq si më poshtë vijon:

	në/lekë
I-TË ARDHURA	
a) Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme 2025	**480,801,000**
b) Buxheti i Pavarur 2025	**300,050,000**
c) Transferta e Pakushtëzuara Sektoriale	**223,821,000**
• Arsimin parashkollor+mbështetës	124,155,000
• Arsimin Parauniversitar	13,021,000
• Mbrojtja nga Zjarri e Shpëtimi	21,254,000
• Administrimin e Pyjeve	7,154,000
• Rrugët	11,066,000
• Ujitjen dhe Kullimin	47,172,000
Shuma	**1,004,672,000**

II-SHPENZIME

A-Bashkia Qendër

1-Paga+ Sigurime Shoqërore :

1.	Aparati Administrativ	189,323,000
2.	Policia Bashkiake	12,086,000
3.	MZSH	18,287,000
4.	Sek.mbështetës	6,813,000
5.	Arsimi Parsh.Transf.Spec	124,155,000
6.	Arsimi Mesëm Trasf.Spec	13,021,000
	Shuma	**363,685,000**

2-Shpenzime Operative

1.	Aparati Administrativ	53,981,000
2.	Policia Bashkiake	1,266,000
3.	MZSH	3,127,000
4.	Sek.Mbështetës	65,045,000
5.	Arsimi 9-vjeçar (të veta)	370,000
6.	Arsim i mesem (të veta)	290,000
	Shuma	**124,079,000**

3-Investime (230-231)

1.	Hartim projekte	1,100,000
2.	Ndërtime Konstruksione	27,765,000
3.	Rrugë	67,118,000
4.	Ujësjellës Kanalizime	7,700,000
5.	Pajisje Instalime Teknike,instrumenta vegla	1,890,000
6.	Inventar Ekonomik	9,516,000
7.	Mbikqyrje + Kolaudim	2,000,000
8.	Detyrime nga viti 202 (në proces)	109,704,000
	Shuma	**226,793,000**

4-Gjatë vitit 2025 të realizohen dy investime të shtrira në kohë për periudhën 2025-2027 si më poshtë:

a) **"Sistemim – Asfaltim rrugë viti 2025"** në shumën 100,000 mijë lekë të ndara në financim:
   Viti 2025 30,000 mijë lekë
   Viti 2026 35,000 mijë lekë
   Viti 2027 35,000 mijë lekë

b) **"Ndërtim korsi biçikletash dhe Trotuare Kryqëzimi Libonik, Pylli Fazanëve"** në shumën 30,000 mijë lekë e ndara në financim
   Viti 2025 5,000 mijë lekë
   Viti 2026 25,000 mijë lekë

4-Të Tjera

1.	Transfertë 1 % Drejtoria Rajonale e Tatimeve	50,000
2.	Shpërblim, Kuotë Ushq, Dieta,Fjetje "Klubi Futbollit Maliq"	10,804,000
3.	Transf. Kombinati Sheqerit(shlyerje detyrime pwr kalim nw likujdim)	5,200,000
4.	Fond Këshilli Qarkut	300,000
5.	Fond Social	1,000,000
6.	Fond Mbrojtje Civile	4,000,000
7.	Transfertë tek individët	120,000
8.	Fond për bursa për nxënësit ekselentë	500,000
9.	Fond rezervë	2,000,000

II-SHPENZIME

A-Bashkia Qendër

1-Paga+ Sigurime Shoqërore :

1.	Aparati Administrativ	189,323,000
2.	Policia Bashkiake	12,086,000
3.	MZSH	18,287,000
4.	Sek.mbështetës	6,813,000
5.	Arsimi Parsh.Transf.Spec	124,155,000
6.	Arsimi Mesëm Trasf.Spec	13,021,000
	Shuma	**363,685,000**

2-Shpenzime Operative

1.	Aparati Administrativ	53,981,000
2.	Policia Bashkiake	1,266,000
3.	MZSH	3,127,000
4.	Sek.Mbështetës	65,045,000
5.	Arsimi 9-vjeçar (të veta)	370,000
